



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SHKODËR

ANALIZA E PUNËS SË GJYKATËS TË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR
GJATË VITIT 2023

SHKODËR 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2024

**ANALIZA E PUNËS SË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM SHKODËR
GJATË VITIT 2023**

HYRJE

Materiali vijues përfaqëson në mënyrë të përmbledhur punën e kryer nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për periudhën 01 Janar 2023 - 30 Prill 2023 dhe në vijim Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për periudhën në vijim si dhe problematikat e hasura gjatë këtij viti sa i takon funksionimit të institucionit në tërësi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër si dhe çdo gjykatë tjetër në Republikën e Shqipërisë, gjatë vitit 2023, i është nënshtruar implementimit të hartës së re gjyqësore në referim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495 datë 21.07.2022 "Për riorganizmin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave".

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, u përfshi në tre fazat e mëposhtme të implementimit të hartës së re gjyqësore:

- Ristrukturimit të gjykatave të apelit;
- Ristrukturimit të gjykatave të shkallëve të para;
- Ristrukturimit të gjykatave administrative të shkallëve të para.

Për shkak të këtij procesi të ndërmarrë nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me gjykatat, konkretisht sa i përket gjykatës sonë, punonjës të Gjykatës së Apelit Shkodër, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, u transferuan pranë kësaj gjykate si rezultat i vendimeve të Komisioneve të Ristrukturimit të ngritura në përputhje me vendimin 557 datë 29.12.2022 të KLGJ-së.

Sa më sipër Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër e filloi vitin 2023 me organikë të përbërë nga:

Me 60 punonjës referuar vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 555 datë 29.12.2022 "Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe gjykatave të rretheve, nga ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nga gjykatë me 48 punonjës, kaloi në 60 punonjës ndër të cilët administratë 46 (dyzet e gjashtë).

Me 75 punonjës , referuar vendimeve nr. 146, 148 dhe 150 datë 29.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përmes të cilëve është përcaktuar numri i gjykatave në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në referim të Vendimit nr. 136, datë 28.03.2023 ku është përcaktuar dhe vendosur që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër përfundon veprimtarinë e saj në datë 30.04.2023 dhe me datë 01.05.2023 fillon veprimtarinë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me 75 punonjës, ndër të cilët 60 administratë gjyqësore, shpërndarë sipas vendimit nr. 4 datë 31.03.2023 (nr. 483 prot, datë 31.03.2023) dhe transferuar sipas vendimit nr. 5, datë 05.04.2023 të Këshillit të Gjykatës (Nr. 510 prot, datë 05.04.2023).

Për funksionimin e kësaj gjykate në përputhje vendimin nr. 136 datë 28.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u realizua edhe faza e dytë e implementimit të hartës së re gjyqësore, konkretisht bashkimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë me atë Shkodër, në përputhje edhe me vendimin nr. 557 datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në përfundim të sa më sipër, gjatë vitit kalendarik 2023, për shkak të implementimit të hartës së re gjyqësore, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ndryshoi si më poshtë:

VITI 2020		VITI 2023	
Nr. Gjyqtarëve	Administrata	Nr. Gjyqtarëve	Administrata
14	34	15	60

Këto vende vakante të krijuara për shkak të shtimit të organikës, në zbatim të implementimit të hartës së re gjyqësore, u plotësuan fillimisht me vendimin e Këshillit të Gjykatës nr. 150 prot., datë 01.02.2023 “Për transferimin e punonjësve të Gjykatës së Apelit Shkodër, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, (punonjësve me status)”; Vendimin e Kancelarit për punonjësit e tjerë nr. 152 prot, datë 01.02.2023 “Për transferimin e punonjësve të Gjykatës së Apelit Shkodër, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër (punonjësve të tjerë)”; Me vendimin nr. 8 datë 25.04.2023 të Këshillit të Gjykatës “Për transferimin e Punonjësve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”. Me vendimin nr. 11, datë 26.06.2023 të Këshillit të Gjykatës “Për transferimin e punonjësve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”.

Numri i gjyqtarëve në raport me organikën e miratuar ka qenë me mungesa dhe si më poshtë: Vitin 2023 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e filloi me trupe gjyqësore të përbërë nga 7 (shtatë) gjyqtarë organikë dhe 2 (dy) gjyqtarë të transferuar (një në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe një në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut Strasburg) të cilët janë si më poshtë:

- Sokol Shehu;
- Arbër Çela;
- Arta Llazari;
- Izabela Radovani;
- Hasan Selimi;
- Besmir Stroka;
- Orgent Nazaj;
- Gentian Jahjoli (transferuar në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut Strasburg);

- Tonin Sterkaj (transferuar në Gjykatën e Apelit Shkodër).

1. Me datë 01.02.2023 , i ka mbaruar transferimi gjyqtarit Tonin Sterkaj me vendimin nr. 47 datë 27.01.2023 , këshillit të Lartë gjyqësor është vendosur : Përfundimi përpra afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtarin z. Tonin Sterkaj, vendim që i ka filluar efektet në datë 01.02.2023
2. Me datë 28.02.2023 referuar vendimit nr. 69 datë 09.02.2023 KLGJ- ja ka deklaruar përfundimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin Hasan Selimi, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.
3. Me datë 14.04.2023 me vendim të KPK-së është shkarkuar gjyqtarja Izabela Radovani.
4. Me datë 01.05.2023 referuar vendimeve nr. 136, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër , nr. 146 datë 29.03.2023 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm” dhe nr.147, datë 29.03.2023 “Për përcaktimin e kategorisë së gjyqtarëve” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i janë bashkuar trupës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, përkatësisht magjistratët Amarilda Sulaj dhe Albert Keraj, si dhe ka mbaruar periudha e transferimit gjyqtarës Kostandina Kuro.
5. Prej datës 01.05.2023 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka funksionuar nga 15 gjyqtarë organikë me 10 gjyqtarë në fakt si më poshtë:
 - 1) Sokol Shehu;
 - 2) Arbër Çela;
 - 3) Arta Llazari;
 - 4) Besmir Stroka;
 - 5) Orgent Nazaj;
 - 6) Tonin Sterkaj ;
 - 7) Kostandina Kuro;
 - 8) Amarilda Sulaj;
 - 9) Albert Keraj;
 - 10) Gentian Jahjollli (transferuar në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut Strasburg).
6. Ky numër gjyqtarësh ka ndryshuar në muajin shtator dhe tetor për shkak të transferimeve të gjyqtareve Amarilda Sulaj dhe Kostandina Kuro dhe emërimit të tre magjistrateve Elona Mërtiri, Anisa Brinja (Tepelena) dhe Egla Mirashi, trupë gjyqësore që ka vijuar deri në përfundim të vitit 2023.
7. Pranë kësaj gjykate kanë funksionuar seksionet civil, penal dhe penal për të mitur ku më poshtë për shkak të ndryshimeve të shpeshta në trupë gjyqësore që ka patur gjykata po referojmë vetëm ndarjen e fundvitit si vijon:
 - Seksioni civil përbehet nga gjyqtarët: Arta Llazari, Albert Keraj, Elona Mërtiri, Anisa Brinja (Tepelena) dhe Egla Mirashi .
 - Seksioni penal përbehet nga gjyqtarët: Sokol Shehu, Tonin Sterkaj, Arbër Çela, Besmir Stroka dhe Orgent Nazaj;
 - Seksioni penal për të mitur përbehet nga gjyqtarët: Sokol Shehu, Tonin Sterkaj, Arbër Çela, Besmir Stroka dhe Orgent Nazaj;

Sa i përket organigramës së kësaj gjykate, ajo pësoi ndryshime gjatë vitit 2023 të cilin e paraqesim si më poshtë :

Nr.	Funksioni	ORGANIKA E VITIT 2022	ORGANIKA E VITIT 2023
1.	Kryetar	1	1
2.	Zv. Kryetar	1	1
3.	Gjyqtarë	13	13
4.	Kancelar	1	1
5.	K/sekretar	1	2
6.	Sekretar gjyqësor	16	18
7.	Kryetar i Degës Buxhetit	1	1
8.	Specialist finance	0	1
9.	Specialist Buxheti	0	1
10	Magaznier	1	2
11	Shef Burimesh Njerezore	0	1
12	Specialist Burimesh Njerezore dhe shërbime mbështetëse	0	1
13	Specialist Prokurimesh	0	1
14	Sanitar	2	4
15	Shofer	1	2
16	Mirëmbajtës	1	2
17	Punonjës sigurie	1	3
18	Nëpunës gjyqësor /ftues	5	10
19	Shef Sektori IT	0	1
20	Specialist IT	1	1
21	Specialist IT dhe Statistike	0	1
22	Specialist i marrëdhënieve me publikun dhe mediat	1	1
23	Shef Sektori Protokoll Arkive	0	1
9.	Specialist Protokolli	0	1
10.	Specialist Arkive	2	1
11.	Nëpunës civil Zyrë Shërbimi Pukë	0	3
TOTAL		48	75

Sa më sipër në vijim në vitin 2023 referuar vendimit nr. 150, datë 29.03.2023 i Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për miratimin e rregullave standarte, për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë Të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, Me zyra shërbimi" Këshilli i Gjykatës në përputhje me organikën e mësipër përshkruar, miratuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor mori vendim për funksionimin e administratës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm me sektorë të ndarë, përmes vendimit nr. 4 datë 31.03.2023 miratoi strukturën e kësaj gjykate si më poshtë:

Nr.	Funksioni	Numri organik	Kategoria e pages
1	Kryetar	1	G-1
2	Zv/Kryetar	1	G-1
3	Gjyqtarë	13	G-1
4	Kancelar	1	II-1
5	Kryesekretar	2	III-2
6	Sekretar gjyqësorë	18	IV-1
7	Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar		
8	Shef Sektori	1	III-2
9	Specialist Buxheti	1	IV-2
10	Specialist Finance	1	IV-2
11	Magaznier	2	IV
12	Sektori i Burimeve Njerezore, Shërbimeve Mbeshtetese dhe Prokurimeve		
13	Shef Sektori	1	III-2
14	Specialist Burime Njerezore dhe shërbime mbështetëse	1	IV-2
15	Specialist Prokurime	1	IV-2
16	Sanitar	4	I
17	Shofer	2	III
18	Mirëmbajtës	2	III
19	Punonjës sigurie	3	I
20	Nëpunës gjyqësor	5	III
21	Ftues	5	III
22	Sektori i IT, Statistike dhe Marrëdhënie me Publikun dhe Median		
23	Shef Sektori	1	III-2
24	Specialist IT	1	IV-2
25	Specialist IT dhe Statistike	1	IV-2
26	Specialist Marrëdhënie me Publikun dhe Median	1	IV-2
27	Sektori i Koordinimit të Zyrave të Shërbimeve dhe Protokoll/Arkive		
28	Shef Sektori	1	III-2
29	Specialist Protokoll	1	IV-2
30	Specialist Arkive	1	IV-2
31	Zyra e Shërbimit Pukë	3	IV-2

Referuar kësaj strukture organizative të Gjykatës, Këshilli i saj, për vitin 2023 ka përfunduar procedurat e transferimeve të punonjësve të gjykatave të tjera gjatë tre fazave të implementimit të hartës së re gjyqësore si më poshtë:

1. Procedura e transferimit të punonjësve të propozuar nga Komisioni i Ristrukturimit të Gjykatave të Apelit të Përgjithshëm përfunduar konkretisht me Vendimet e Këshillit të Gjykatës nr. 150 Prot, datë 01.02.2023 për nëpunësit civil dhe nr. 152 prot., datë 01.02.2023 për transferimin e punonjësve të tjerë, ku organikës së gjykatës iu shtuan punonjësit: Valbona Hoxha, Nikoleta Belaj, Aida Okaj, Benizar Ibrahimimi dhe Brisid Hasi (nëpunës civil gjyqësor) dhe punonjësit Sokol Ulqinaku, Sadetin Oroshi, Fatbardha Lekaj, Verjana Beqiri, Rrok Kaçurri, Erjon Lekaj, Xhenis Dema dhe Xhelal Kraja duke filluar detyrën pranë kësaj gjykate në datë 01.02.2023.
2. Procedura e transferimit të Punonjësve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë , e cila përfundoi me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr 192 datë 26.04.2023 për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë si dhe me vendimin nr.8 datë 25.04.2023 të Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për transferimin e punonjësve: Esmeralda Kukaj, Agostin Koca, Fiqirete Latifi, Marte Suta, Esma Islami, Adrian Hoxha, Afrim Selmani, Pashkë Prendi dhe Naime Neziri, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Kraja duke filluar detyrën pranë kësaj gjykate në datë 01.05.2023.
3. Procedura e transferimit të punonjësve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka përfunduar me vendimin nr. 11 datë 26.06.2023 të Këshillit të Gjykatës, ku u vendos transferimi i përhershëm i punonjësve Nertila Kalldrica – Kryesekretare, Ardjana Lumani, Armis Lumani dhe Ylli Çuliqi, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Kraja duke filluar detyrën pranë kësaj gjykate në datë 01.07.2023.

Në vijim të sa më sipër u relatua , filluan dhe u përfunduan procedurat në përputhje me Ligjin nr. 98/2016 “Për Organizmin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë “, i ndryshuar, vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil” si dhe vendimit nr. 150 datë 29.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për pozicionet si më poshtë:

- Për pozicionin e shefit të Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, procedurë që u përfundua duke emëruar znj. Florinda Gega;
- Për pozicionin e shefit të Sektorit të Protokollit, Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit, procedurë që u përfundua duke emëruar znj. Anita Kolombi.
- Për pozicionin e shefit të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, procedurë që u përfundua duke emëruar znj. Blenda Behri.
- Për pozicionin Nëpunës civil pranë Zyrës së Shërbimit Pukë procedurë që u përfundua duke emëruar z. Angjelin Deda;

- Për 2 pozicione sekretare gjyqësore u përfunduar me vendimin e këshillit të Gjykatës nr. 22 datë 29.12.2023 duke emeruar znj. Adela Lipe dhe Laura Molla, duke filluar marrëdhëniet financiare në muajin janar , respektivisht datë 09.01.2024 dhe 20.01.2024.
- Gjithashtu u fillua procedura për pozicionin e punës “specialist arkive”, procedurë e cila përfundoi në vitin pasardhës.

Për reflektimin e treguesve të punës, në këtë analizë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për vitin 2023, është vlerësuar të trajtohen treguesit që lidhen me performancën në menaxhim dhe në vendimmarrje, si dhe tregues që lidhen me tendencën e punës së gjykatës gjatë këtij viti.

Në funksion të një analize trajtuese dhe krahasuese me vitet e mëparshme, treguesit e punës janë evidentuar për çdo gjyqtar më vete dhe për Gjykatën në tërësi si trupë gjyqësore.

Gjithashtu, këtu do të bëhet krahasimi i ngarkesës së kësaj gjykate duke e krahasuar dhe me vitet e mëparshme. Në këtë përmbledhje do të prezantohet dhe ngarkesa, shpejtësia dhe cilësia në aspektin e ecurisë së vendimeve në gjykatat më të larta për secilin gjyqtar.

Në këtë analizë do të mund të vlerësohet dhe trendi i ngarkesës dhe llojit të çështjeve në këtë gjykatë, pra cilat lloje të çështjeve janë rritur më shumë në vitin e fundit si dhe problematika të ndryshme që shtrohen për zgjidhje.

Po kështu, në material janë trajtuar shkurtimisht edhe aspekte që lidhen me infrastrukturën, teknologjinë dhe shërbimet administrative të ofruara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, elementë këta që gjithashtu vlerësohen të kenë ndikim në performancën e gjykatës.

I. Infrastruktura.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër aktualisht vazhdon të jetë e vendosur në tre katet e para (katin e parë dhe të tretë pjesërisht) të godinës ekzistuese, e cila rezulton të jetë përshtatur për të kryer funksionin e Gjykatës. Gjithashtu kjo godinë shfrytëzohet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër (sot zyra e shërbimit) sa i përket një pjese të katit të parë dhe katit të katërt si dhe ambientet e përbashkëta (shkallët e korridoret) , dhe Zyra Përmbartimit Shkodër, e cila ushtron veprimtarinë e saj gjysmën e katit të tretë të kësaj gjykate .

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër edhe pse Gjykata e Apelit Shkodër është transferuar në Apelin e Përgjithshëm Tiranë dhe ajo Administrative e Shkallës së Parë Shkodër është bashkuar me Administrativën e Shkallës së Parë Tiranë , përsëri veprimtarinë e saj vijon që ta ushtrojë në të njëjtën sipërfaqe dhe në të njëjtat ambiente që ka patur më përpara, kur organika e saj ishte 48 (dyzet e tetë) punonjës, dhe sot që është 75 (shtatëdhjetë e pesë) punonjës.

Siç edhe u parashtrua në fillim referuar ndryshimeve të infrastrukturës së burimeve njerëzore, duke qënë se shtimi i saj ishte i konsiderueshëm dhe menjëhershëm, u krijua një situatë pamjaftueshmërie madje duke tejkaluar normalen për akomodimin e burimeve njerëzore në

kushte të përshtatshme pune në përputhje dhe me detyrat e funksionet e tyre, madje duke lënë një pjesë të mirë të punonjësve të shërbimit pa ambiente të përshtatshme akomodimi, ose edhe fare.

Nderkohë që trupa gjyqësore dhe sekretaria u akomoduan të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në një zyrë (gjyqtar dhe sekretari), sektorët e krijuar përveç Arkivës dhe atij të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar (që kanë qënë si zyra funksionale edhe më përpara) nuk kanë ambiente të përcaktuara pune, por kanë ushtruar funksionet e tyre në ambiente të ndërthurura me punonjës të sektorëve të tjerë apo edhe ndërthurur me sekretari gjyqësore, aty ku ka qënë e mundur.

Aktualisht gjendja e godinës përveç pamjaftueshmërisë së saj, paraqitet tejet e amortizuar dhe tërësisht e papërshtatshme për ushtrimin e detyrës nga ana e gjyqtarëve dhe administratës, si dhe për garantimin e transparencës, trajtimit dinjitoz e solemn të qytetarëve në kërkesat e tyre apo seancat gjyqësore.

Ambientet (*veçanërisht ato të katit të parë*) kanë lagështirë dhe muret janë të dëmtuara si në ambientet e jashtme, ashtu edhe në ato të brendshme të gjykatës.

Veç sa më sipër, godina ekzistuese paraqet problematikë edhe përsa i përket pozicionimit, hapësirave dhe planimetrisë, të cilat bëjnë që kjo Gjykatë të jetë tërësisht e papërshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka vetëm 7 salla gjykimi të shtrira në katin e dytë, katin e tretë dhe katin e katërt:

- Një sallë (në katin e dytë) shërben edhe sallë gjyqi edhe sallë për mbledhje.
- 2 (dy) në katin e dytë , përdoren ekskluzivisht vetëm për gjykime penale me të pandehur në gjendje arresti,
- ndërsa 4 (katër) sallat e tjera përdoren nga të gjithë gjyqtarët sipas planifikimeve të kryera nëpërmjet kalendarit elektronik.

Gjatë vitit 2023 gjyqtarët përgjithësisht kanë shfrytëzuar sallat duke realizuar gjykimet me sistem audio, pasi siç u pasqyruar edhe më sipër numri i gjyqtarëve ka qënë më i vogël se organika, mesatarisht gjatë vitit kanë ushtruar funksionet **8.4 gjyqtarë** .

Në lidhje me sallat e gjykimit duhet theksuar se sallat aktuale të gjykimit nga madhësia, pikëpamja teknike dhe pozicionimi i tyre nuk ofrojnë as zhvillimin në kushte normale të gjykimit dhe as nuk garantojnë sigurinë e gjyqtarëve apo administratës mbështetëse .

Në mbrojtjen e punës së pavarur të gjyqtarit, një rol të rëndësishëm janë dhe godina e ambientet, zyrat, roja i sigurisë në hyrjet në gjykatë.

Çështja e sigurisë për gjyqtarët duhet të merret parasysh në mënyrë serioze e të trajtohet nga ana e KLGJ-së. Pasiguria në rritje e gjyqtarëve ndikon jo vetëm në pavarësinë dhe paanësinë e gjykatave, por gjithashtu dëmton besueshmërinë dhe autoritetin e institucionit gjyqësor në sytë e publikut.

Aktualisht gjendja e sigurisë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër paraqitet tejet e ulët. Godina ekzistuese nuk garanton as nivelet minimale të sigurisë së

gjqtarëve dhe punonjësve të tjerë të administratës gjyqësore. Në hyrje të Gjykatës është vendosur derë detektimi.

Në godinën e gjykatën jemi përpjekur që të këtë dy hyrjet e saj, të ndara. Njëra është krijuar për administratën dhe gjyqtarët dhe gjithë përdoruesit e tjerë të cilët duhet të hyjnë në gjykatë dhe hyrja tjetër përdoret vetëm për të pandehuroit e shoqëruar nga shërbimet e IEVP-ve apo Komisarariatit të Policisë pranë Drejtorive Vendore të Policisë, duke i përcjellë të pandehurit në dhomat e izolimit në mënyrë që të presin paraqitjen në seanca gjyqësore.

Nga ana tjetër, asnjë nga sallat e gjykimit nuk kanë as dhomë këshillimi dhe gjyqtarët kur hyjnë dhe dalin në sallë ndodhen në të njëjtin ambient me qytetarët, çka nuk garanton as nivelet minimale të sigurisë të gjyqtarëve.

Parkimi i gjykatës ka kapacitet vetëm për 5-6 automjete, (përfshirë Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe Zyrës së Përmbarimit Shkodër) çka bën që gjyqtarët dhe administrata të parkojnë në ambiente të jashtme të gjykatës, në të cilat nuk mund të garantohet siguria.

Kështu, si gjatë seancave gjyqësore edhe jashtë tyre gjyqtarët kanë një nivel sigurie më pak se minimal, jashtë standardeve evropiane.

Në lidhje me shërbimin e sigurisë, sipas legjislacionit në fuqi nga Komisarati i Policisë Shkodër ofrohet asistencë me një punonjës policie në orarin 08:00-15:00, ndërkohë nga ora 15:00-08:00 të ditës pasardhëse shërbimi i sigurisë ofrohet nga një punonjës i shoqërisë private “Illyrian Guard” sh.a, të cilët kanë trajnimin e duhur profesional për të garantuar sigurinë specifike të gjykatës. Kjo fashë orare ndahet në dy pjesë 15:00 -24:00 ambienti i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ruhet fizikisht nga punonjësit e Illyrian Guard, ndërsa nga ora 24:00 – 08:00 ruhet përmes sistemeve të kësaj shoqërie të instaluar në salla operative.

Për përcaktimin e rregullave, detyrimeve reciproke dhe përgjegjësi, është nënshkruar një Rregullore e Përbashkët e Sigurisë ndërmjet Gjykatës dhe Shoqërisë Private në përputhje me kontratën e lidhur mes Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shoqërisë Illyrian Guard për vitin 2023.

Sa i takon shërbimeve të ofruara qytetarëve nga ana jonë është përshtatur një sportel ku ofrohen shërbimet e Kryesekretarisë dhe shërbimet e tjera si: tërheqja e vërtetimeve, kopjeve të akteve apo vendimeve gjyqësore, etj.

Në lidhje me shërbimet e zyrës së buxhetit dhe fianacës tashmë Sektori i Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit, ato kryhen brenda ambienteve të gjykatës në bashkëpunim me zyrën “Arka”.

II. Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe regjistrimi AUDIO i seancave gjyqësore.

Siç është parashtruar edhe në analizat vjetore të mëparshme, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, që nga viti 2010 e në vijim ka organizuar punën e saj duke u bazuar në sistemin e integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore CCMIS/ICMIS.

Gjatë vitit 2023 nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë ndërmarrë veprime, ndjekur protokolle dhe realizuar punime të shumta në përmirësimin e funksionimit të sistemit, dhe gjithashtu në përpunimin e të dhënave të ndryshme që përbëjnë parametra të rëndësishëm të veprimtarisë së gjykatës. Tashmë sistemi raporton të dhëna të grumbulluara dhe përpunuara në përputhje me shumë format raportime të kërkuara si nga institucionet vendase ashtu edhe ato të Komunitetit Evropian.

Asesi në lidhje me çdo problematikë të mundshme të hasur ndërlidhja e specialistëve IT të gjykatës ka qënë e shpejtë si me drejtorinë e IT-së dhe Menaxhimin të Çështjeve, ashtu edhe përfaqësuesit e kompanisë së suportitit “Kreatix”, e kontraktuar nga KLGJ-ja për suport në lidhje me sistemin ICMIS dhe sistemin e menaxhimit financiar që operon në gjykata. Nga ana e kësaj të fundit janë marrë masat e nevojshme për rikthimin në gjëndje funksionale të faqes së gjykatës apo dhënien e një zgjidhje problemeve të hasura.

Aktualisht faqja zyrtare elektronike e gjykatës kryen në mënyrë automatike të gjithë procesin e paraqitjes së të dhënave në portalin gjykata.gov.al. Në portalin e gjykatave në hapësirën e dedikuar Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër shfaqet në mënyrë automatike lista e përditësuar e çështjeve gjyqësore, lista e shortit, kalendari i seancave si dhe çdo informacion tjetër që përbën interes publik.

Sistem tjetër që vepron në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është sistemi dixhital audio RDA, i cili është instaluar dhe implementuar në 7 (shtatë) salla gjykimi dhe vazhdon të jetë efektiv dhe tërësisht funksional.

Ndërkohë, regjistrimi i seancave gjyqësore Audio është kthyer tashmë në një shprehje të zakonshme të gjyqtarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në gjykim, duke pasur vlera të rëndësishme sa i takon rritjes së transparencës dhe solemnitetit të gjykimit.

Sigurinë e të dhënave lidhur me çështjet e regjistruara në sistemin RDA, në serverin e gjykatës, e mundëson software i instaluar Backup Chain Software. Ky Software shërben për të bërë backup Incremental regjistrimet Audio nga serveri lokal drejt Serverit qendror tek AKSHI, Tiranë. Për të punuar në mënyrë të rregullt sistemi monitorohet dhe mirëmbahet nga stafi IT (specialistëve të IT) i mbështetur nga Forsitec shpk (e cila është kontraktuar nga KLGJ-ja për backup-et e RDA).

Bazuar në zhvillimet e fundit lidhur me sistemin Audio, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmirësuar shërbimin e Internetit, duke rritur shpejtësinë "Upload", në mënyrë që transferimi i të dhënave në serverin e qendror të jetë sa më i shpejtë dhe i sigurtë.

Sa i përket sigurisë së të dhënave që gjykata prodhon, përpunon dhe ruan, më konkretisht, të sistemit ICMIS dhe dokumenteve të ndryshme elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, nga ana e IT-së kryhet rregullisht çdo ditë backup-i lokal i këtyre të dhënave në NAS, përveç Backup-it të përgjithshëm që realizon Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit pranë KLGJ-së. Gjithashtu nga ana e kësaj të fundit janë

ndërmarrë veprime, krijuar protokolle dhe trajnuar IT-të e gjykatave për marrjen e masave si në parandalimin ashtu edhe në zgjidhjen e probleme që mund të lindin nga tendenca për vjedhjen e të dhënave të prodhuara apo të lëna në ruajtje.

Gjatë vitit 2023 me Urdhërin 284 datë 16.06.2023 Agjencia Kombëtare e Shoqërisë dhe Informacionit që ndërvepron nën varësinë e Këshillit të Ministrave ka miratuar “Rregulloren për përdorimin e postës elektronike në administratën publike”.

Gjithashtu nga ana e KLGJ-së, Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit sa i përket sigurisë kibernetike janë marrë masat dhe krijuar gjithashtu protokolle, konkretisht gjatë këtij viti me instalimin e Antivirusit-SYMATEC ENDPOINT PROTECTION, si dhe përditësime të shpeshta të sisteme operative të cilat mbikqyren si nga IT-të e gjykatave por edhe nga vetë drejtoria e mësipërcituar pranë KLGJ-së e cila orienton menjëherë IT-të në zgjidhjen e problematikës.

Po ashtu gjatë vitit 2023 ka filluar instalimi i paisjeve për regjistrimin e seancave gjyqësore edhe në formë vizive, duke përmirësuar kështu sistemin RDA. Kjo veprimtari është zhvilluar nga ana e KLGJ-së dhe IT-ve të gjykatave, dhe në përputhje me ta janë instaluar paisjet teknologjike të nevojshme për realizimin e këtij projekti, i cili pritet të marrë jetë gjatë viti 2024.

Gjithashtu nga ana e KLGJ-së janë organizuar takime dhe trajnime në lidhje me raportin që gjykata duhet të ketë me median dhe publikun.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiskionit të Përgjithshëm Shkodër ka qënë gjithmonë korrekte në informacionin e përcjellë si në përgjigje të kërkesave të përdoruesve të gjykatës ashtu edhe në mirëmbajtjen e faqes zyrtare të Gjykatës apo Programin e transparencës.

Gjatë këtij viti nga ana e specialistit për marrëdhënien me publikun janë trajtuar kërkesa me bazë ligjore Ligjin “Për informimin publik”, gjithsej 20 (njëzet) kërkesa, ndërkohë në bashkëpunim edhe me kryesekretarinë e gjykatës janë regjistruar në regjistrin elektronik të kërkesave për shërbim rreth 2046 (dy mijë e dyzet e gjashtë) kërkesa me objekt informacion apo kërkesa për shërbime gjyqësore.

Siç u relatua më sipër në përfundim të këtij viti tashmë gjykata ka edhe sektorin e saj të *Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, i cili në vijim do procedojë me programe të përcaktuara në rritjen e cilësisë sa i përket shërbimeve teknologjike, informuese dhe nxjerrjen e të dhënave statistikore si analizë thelbësore në rritjen dhe përmirësimin e veprimtarisë gjyqësore në tërësi.*

III. Kryesekretaria dhe sekretarët gjyqësorë.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiskionit të Përgjithshëm Shkodër, për shkak të numrit të reduktuar të gjyqtarëve, po përballlet më një ngarkesë pune të konsiderueshme e cila sa vjen dhe është në rritje dhe reflekton edhe në veprimtarinë e përditshme të administratës gjyqësore. Kryesekretaria është sektori më i ngarkuar me punë administrative në këtë gjykatë dhe ka përgjegjësinë kryesore për shërbimet ndaj publikut. Me gjithë përpjekjet maksimale konstatohet se numri i punonjësve që shërbejnë në Kryesekretari është i pamjaftueshëm. Kështu, puna voluminoze në Kryesekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiskionit të Përgjithshëm Shkodër gjatë këtij viti është përballuar nga 1 kryesekretare si dhe kryesekretarja tjerër e

emëruar në muajin korrik dhe dy sekretare (një sekretare regjistruese dhe sekretarja pranë kryesekretarisë), të cilat për të përballuar volumin e madh të punës janë detyruar të punojnë çdo ditë jashtë orarit.

Gjatë vitit 2023 kryesekretaria e gjykatës ka hasur ndër të tjera probleme për shkak të punës së shtuar si rezultat: së pari i bashkimit të gjykatave edhe së dyti hapsirës së kufizuar që ka ndodhur për shkak të pamundësisë për të depozituar dosjet në arkivë, e cila gjithashtu nuk ka hapsira më të lira për të sistemuar material arkivor. Kjo solli punë të shtuar në kryesekretarinë e gjykatës, ku kjo e fundit realizoi edhe shërbimin arkivor mbi dojet e viteve të mëparshme që mban nën administrim (2021-2023). Kjo gjë erdhi si rezultat i mospatjes së hapsirave në dispozicion, dhe pritjes së sistemimit të Dhomës Penale në ambientet e ish- Gjykatës së Apelit Shkodër, proces i cili nuk u arrit të realizohet gjatë vitit 2023.

Shërbimi i kryesekretarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në lidhje me publikun shtrihet në një hark kohor prej orës 08:00-16:00 për veprime të ndryshme me qytetarët dhe avokatët, si dhe përdoruesit e tjerë. Ky orar i shërbimit në sportel, ka sjellë për rrjedhojë një ngarkesë tejet të madhe dhe të papërballueshme nga ana e nëpunësve gjyqësorë në Kryesekretari, për shkak edhe të detyrave të tjera që kjo zyrë shërbimi ka në lidhje me veprimtarinë administrative të gjykatës.

IV. Arkiva

Përsa i përket arkivës paraqitet një problematikë serioze që ka të bëjë me mungesën e hapësirave të mjaftueshme për të sistemuar materialin arkivor, konkretisht dosjet penale dhe civile në një ambient të vetëm dhe të përshtatshëm. Në mungesë të hapësirave të përshtatshme, arkiva është e shpërndarë në disa ambiente të ndryshme të gjykatës.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk ka ambiente të mjaftueshme për sistemimin e dosjeve gjyqësore në përputhje me ligjin për arkivat dhe aktet e tjera nënligjore dala në zbatim të tij. Një pjesë e këtij materiali arkivor është sistemuar përkohësisht në zyra të ndryshme të përdorura më përpara nga gjyqtarët apo administrata e gjykatës, pasi nuk ka asnjë ambient tjetër të përshtatshëm për këtë qëllim.

Gjithashtu sa i përket Akivit nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është iniciuar dhe po vijon bashkëpunimi me PC-Store “Për digjitalizimin e Gjykatave në zbatim të kontratës Nr. 2552/15 prot., datë 19.07.2022” realizuar për gjykatën tonë me datën 12.01.2023 ka filluar zbatimin I planit për digjitalizimin e materialit arkivor për Gjykatën e Shkodrës, ku gjatë vitit 2023 ka përfunduar digjitalizimi i materialit si më poshtë vijon:

- Numratorët penal themeli, civil themeli dhe penale ushtarake për vitet 1997 -2022;
- Kodekse penale themeli, civile themeli, penale ushtarake, kërkesa penale, civile të veçanta, gjykime administrative penale të karakterit të ngutshëm (masa sigurimi e tjerë), Urdhërat e ekzekutimit, Urdhëra të mbrojtjes për vitet 2005-2022, duke vijuar puna me vitin 2004;
- Rregjistra penale themeli, civile themeli, penale ushtarake, kërkesa penale, civile të veçanta, gjykime administrative penale të karakterit të ngutshëm (masa sigurimi e tjerë), Urdhërat e ekzekutimit, Urdhëra të mbrojtjes për vitet 1997-2022;

- Indekse penale themeli, civile themeli, penale ushtarake, kërkesa penale, civile të veçanta, gjykime administrative penale të karakterit të ngutshëm (masa sigurimi e tjerë), Urdhërat e ekzekutimit , Urdhëra të mbrojtjes për vitet 2011-2020, vijon përpunimi i fondit arkivotr me këtë zë , 2008-2010.

Gjatë vitit 2023, kemi vazhduar me përpunimin dhe dërgimin e dokumentacionit nga viti më i hershëm për transferimin e dokumentacionit sipas anekseve të miratuara me Urdhrin Nr. 4895/4 Prot., datë 01.11.2016 në ASHSGJ Lundër.

Nga ana e Arkivit akoma nuk është filluar me implementimin e vendimit nr. 426 datë 14.10.2022 të Këshilli i Lartë Gjyqësor “Për miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumentave gjyqësore që arkivohen në gjykata”, pasi nga ana e Këshillit të Gjykatës për shkak të ngarkesës së shtuar që ka patur gjatë vitit 2023 më qëllimin siç u tha më sipër implementimin e hartës së re gjyqësore për gjykatën tonë duke theksuar këtu edhe krijimin e sektorëve të ri në rastin konkret atë të Protokoll Arkivit dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit nuk është përfunduar akoma në një plan organizativ për asgjесimin e dosjeve që kanë përfunduar afatin e ruajtjeve dhe krijimin e hapsirave të reja në arkiv.

V. Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Kjo zyrë ka filluar si Dega e Buxhetit për periudhën 01.01.2023 -30.04.2023 duke vijuar më pas si Sektor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Ky sektor gjatë vitit 2023 ndër detyrat e tjera administrative dhe financiare që mbart, ka arkëtuar për interes të Shtetit të ardhurat në formën e taksave të padive dhe taksat mbi aktet dhe shërbimet gjyqësore, garancitë etj. të cilat në total arrijnë vlerën 11,343,831 (*Njëmbëdhjetë milion e treqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e një*) Lekë të derdhura në Buxhetin e Shtetit.

Kjo zyrë siç është referuar në hyrje të kësaj përmbledhje ka ndryshuar emrin e vet duke u kthyer në një strukturë tashmë, sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiare e përbërë nga 5 punonjës, një shef sektori, specialist finance, specialist buxheti (në vakancë gjatë vitit 2023) dhe dy magazinierë, ku njëra ka luajtur rolin e arkëtares.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër rezulton të jetë mjaft efektive në vjeljen që në momentin e dorëzimit të kërkesë-padive dhe kërkesave të tjera të taksës gjyqësore dhe shpenzimeve të njoftimit.

Në bashkëpunim me KLGJ në vitin 2022 e në vijim në vitin 2023 është kaluar në një sistem të ri financiar, “*createx flare*”. Gjatë vitit 2023 ky sistem financiar nuk ka përmbushur kriteret e mirëfeksionimit. Shpresojmë që nga ana e KLGJ-së dhe kompanisë do të merren masa në përmirësimin e këtij programi, duke përfshirë përditësimin e tij me paketat e reja ligjore dhe kërkesave që vijnë në respektim të tyre.

Gjatë vitit 2023 Sektor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiarë pranë kësaj gjykate ka funksionuar me 4 punonjës, nga 5 që ka organikë siç edhe u parashtrua më sipër , gjatë vitit 2023 specialisti i buxhetit ka qënë në vakancë.

Problematikë jo vetëm e gjykatës tonë mbetet mospasja e një mënyre matjeje të shpenzimeve gjyqësore sa i takon kostos të gjykimit, apo kostos së shtyerjes së seancës gjyqësore, e cila aktualisht barazohet vetëm me shpenzimet për njoftimet e palëve. Ndërkohë, në vendet e tjera një kosto e tillë përllogaritet me koston e punës së paguar të gjyqtarit dhe administratës gjyqësore, si dhe me matës të tjerë, të cilët janë të nevojshëm për analizën e kostos më pas. Mbetet për t'u parë në të ardhmen përgatitja dhe vënia në funksionim nga ana Këshillit të Lartë Gjyqësor e një mënyre për përllogaritjen e kostove të mësipërme.

Nga kjo anë do të merren masa nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor që të saktësohet, formalizohet dhe unifikohet formati i llogaritjes së shpenzimeve gjyqësore dhe kodifikimi i tyre sipas gjyqtarëve dhe të mundësohet shtimi i një opsioni në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, ku të evidentohet vlera e objektit të padisë, tarifa gjyqësore dhe pagesa e saj, në mënyrë që të sigurohet kontrolli i kësaj të ardhure.

Po kështu, lidhur me këtë çështje mbetet problematike përcaktimi i tarifave për pagesën e avokatëve kryesisht, psikologëve dhe ekspertëve mbi bazën e seancave gjyqësore apo orëve të punës, përllogaritje e cila do të ishte më e saktë, duke garantuar edhe një trajtim të barabartë të tyre në raport me shërbimin e ofruar.

Problematikë tjetër e mëpërprarshme ka qënë njësia e prokurimit që i ka munguar gjykatës. Për shkak të ndryshimit të strukturës tashmë njësia e prokurimit është përcaktuar referuar vendimit 150 datë 29.03.2023 të KLGJ-së , dhe është krijuar në këtë gjykatë në datë 01.05.2023 duke u bërë pjesë e sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, duke patur një specialist prokurimesh, në përbërje të saj.

VI. PROGRAMI I TRANSPARENCËS

Aksesi në gjykatë është një ndër pikat kyçe të cilës së fundmi i është kushtuar një rëndësi e veçantë. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në përputhje me legjislacionin, në kuadër të përshtatjes edhe të situatës së krijuar (tërmet, pandemi etj..) me qëllim aksesin në gjykatë, shmangien e vonesave, marrjen e shërbimeve nga përdoruesit /qytetarët, vijimin e veprimtarisë administrativo-gjyqësore, ka krijuar kushtet e nevojshme për aksesimin on-line të një sërë shërbimesh në gjykatë të cilat i ofrohen përdoruesve.

Sa më sipër, nëpërmjet faqes zyrtare të gjykatës përdoruesit mund të ndjekin ecurinë e gjykimeve në proces shqyrtimi në të cilat janë palë ndërgjyqëse, mund të aksesojnë një sërë të dhënash statistikore për qëllime studimore, për transparencë etj., mund të shohin në kohë reale shortin elektronik, fazën e gjykimit të çështjes për të cilën janë të interesuar, mund të shikojnë datën e seancës së ardhshme, vendimet përfundimtare etj.

Gjithashtu është zgjeruar mënyra e kërkimit të informacionin në gjykatë si për kërkimet e informacionit po ashtu edhe dokumentacionit.

Aktualisht përdoruesit për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit nga gjykata mund të aplikojnë direkt në *“Formularin për marrjen e dokumentacionit nga Gjykata”* i cili gjendet në

faqen zyrtare të gjykatës si dhe mund të bëjnë kërkesë në postën elektronike të gjykatës: NjoftimeGjykataShkoder@gjykata.gov.al dhe InfoGjykataShkoder@gjykata.gov.al.

Këshilli i Lartë Gjyqësor si një risi për vitin 2021-2023, në rolin e organit qeverisës për sistemin gjyqësor, ka ndërmarrë një sërë projektesh në fushën e teknologjisë, me qëllim ofrimin e shërbimeve inovative për gjyqësorin. Një ndër këto projekte, ishte edhe projekti "Formulari elektronik i aplikimit" i cili është aplikuar nga përdoruesit e gjykatës për marrjen e shërbimeve.

Në kuadër të përmirësimit të shërbimit, ky shërbim elektronik u vjen në ndihmë qytetarëve/përdoruesve të gjykatës që të dërgojnë një aplikim, për tu pajisur me kopje të dokumenteve gjyqësore të tilla si, kopje vendimi viti aktual, kopje vendimi (arkiva), kopje të dosjeve gjyqësore, vërtetim për çështje në proces gjykimi (individ), vërtetim për çështje në proces gjykimi (shoqëri tregtare), vërtetim për ndjekje penale, informacion mbi gjëndjen apo fazën e gjykimit të çështjes etj .

Formulari online i aplikimit, është shtuar tashmë si rubrikë e re, në profilin e çdo gjykate, në portalin www.gjykata.gov.al.

Të dhënat e grumbulluara nga aplikimet, përpunohen dhe ruhen në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*".

Për të nisur procesin e aplikimit për një nga dokumentet e sipërcituara, kërkuesi, plotëson të gjitha informacionet e kërkuara brenda këtij formulari on-line. Pas dërgimit të aplikimit drejt gjykatës, ai procesohet nga nëpunësi i gjykatës, dhe në varësi të informacionit, kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet duke u paraqitur pranë ambienteve të gjykatës ose kur është rasti ato përcillen elektronikisht pa qenë nevoja e paraqitjes fizikisht në gjykatë.

Referuar sa më sipër, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër po bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor me qëllim implementimin sa më të saktë lidhur me komunikimin elektronik, me qëllim trajtimin e këtyre kërkesa që do të vijnë nga ky shërbim i ri.

Siç e relatuam edhe më sipër rregjistri elektronik mbi shërbimet e gjykatës , ku rregjistrohen kërkesa të ndryshme të qytetarëve mban numrin 2046 kërkesa për informacion apo shërbime të ndryshme që përfshijnë informacion ose dokumnetacion, duke përjashtuar kërkesat e institucioneve të ndryshme. .

Në përputhje me nenin 7 të ligjit Nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*" në faqen zyrtare është publikuar programi i transparencës për Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Nëpërmjet këtij programi përcaktohet korniza ligjore e veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit Nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*".

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, nëpërmjet pasqyrimin të tij në faqen zyrtare <http://www.gjykata.gov.al> si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është një institucion që ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve të rrjedhura nga ky ligj, duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji si të detyrueshëm për publikim.

Dokumentacioni i bërë publik, është i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm në bashkëpunim me specialistin e IT-së përditësohet nga data e krijimit të saj referuar kërkesave të publikut të bazuara në Ligjin Nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*.

Koordinatori për të drejtën e informimit përpunon të gjitha kërkesat, kthen përgjigje në rrugë elektronike dhe jep orientimet e nevojshme për qytetarët që të mund të drejtohen pa vështirësi në gjykatë që të marrin informacionin e nevojshëm me anë të fletë-palosjeve, formularëve apo informacionit që gjendet në faqen zyrtare të gjykatës, ndërkohë urdhërat proceduralë apo akte të tjera administrative që kanë të bëjnë me procedurat në gjykatë, janë publikuar rregullisht në faqen e internetit të gjykatës.

Gjatë vitit 2023 janë trajtuar 20 (njëzet) kërkesa në përputhje me ligjin *“Për të drejtën e informimit”*. Në asnjë rast nuk është ushtruar ankim tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Po ashtu gjatë vitit 2023 janë trajtuar 2046 (dymije e dyzet e gjashtë) kërkesa të tjera të depozituara me formularin tip në sportelet e gjykatës apo kërkesa me postë elektronike me objekt: Tërheqje vendimi, aktesh, dokumentacioni apo informacion, të cilat mbahen në një regjistër elektronik që menaxhohet nga Specialisti për Marrëdhënien me Publikun dhe Median.

Sa me sipër në faqen zyrtare të internetit është publikuar dhe formati i ri programit të transparencës sipas udhëzimeve dhe manualit të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në vijim në funksion të analizës së punës për vitin 2023, treguesit e punës do të trajtohen në këto drejtime:

- Volumi i çështjeve civile dhe penale për gjykim gjatë vitit 2023;
- Shpejtësia në gjykim;
- Marrëdhëniet me institucionet e tjera me të cilat lidhet puna e gjykatës.

1. VOLUMI I ÇËSHTJEVE


1.1 Administrimi i çështjeve gjyqësore

Gjatë vitit 2023 në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër janë paraqitur gjithsej për gjykim 5761 çështje gjyqësore të cilat nga të cilat: 2657 çështje të kategorisë civile; 3495 çështje të kategorisë penale .

Nga këta çështje (së bashku me ato të mbartura nga vitit 2022 janë gjykuar :


1. Çështje të kategorisë civile gjithsej 1933 ndër të cilat :

- Civile themeli - 953 çështje
- Urdhëra mbrojtje - 195 çështje
- Urdhëra ekzekutimi - 558 çështje
- Civile administrative - 149 çështje
- Civile në tërësi nga Gjykata e Pukës 46



2. Çështje të kategorisë penale gjithsej 3929 ndër të cilat :

- Penale themeli - 948 çështje
- Penale paraprake – 1190 çështje
- Penale ne fazën e hetimiti - 799 çështje
- Kërkesa të tjera administrative penale - 986 çështje




Administrimi i çështjeve dhe ngarkesa e gjykatës


Administrimi i çështjeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjatë vitit 2023.

Lloji i çështjes		ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE				
		Në pritje të gjyqimit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Të gjykuara	Në pritje të gjyqimit në fund të periudhës	Të regjistruara gjithsej
		1	2	3	4	5
A.	Çështje civile	1176	2007	1933	1250	3183
B.	Çështje penale	607	3754	3929	432	4361
C.	GJITHSEJ (A+B)	1783	5761	5862	1682	7544

Paraqitja grafike




**Paraqitja grafike e ngarkesës
së
Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjatë vitit 2023**



1.2 Menaxhimi i seancave gjyqësore

Numri i seancave të zhvilluara dhe regjistruara sipas të dhënave të Sistemit Elektronik për vitin 2023 për shqyrtimin e çështjeve në total është 13864 në total seanca, ndërsa numri i seancave për vitin 2022 është 13145 në total.

Numri i seancave audio është 12244 seanca audio, e shprehur në përqindje numri i seancave audio për periudhën 1 Janar 2023 deri me 31 Dhjetor 2023, ka qenë 88.3 %, ndërsa diferenca janë mbajtur në zyrë për shkak të përcaktimeve ligjore pasi janë çështje të cillat gjyqtari i gjykon në dhomë këshillimi , si gjyqtar i vetëm konkretisht 1620 seanca , e përkthyer në 11.7 %.




1.3 : Ngarkesa e gjyqtarëve

Ngarkesa e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për vitin 2023 në të gjithë elementet e saj për secilin gjyqtar dhe gjykatën në tërësi është sipas tabelës më poshtë :

Nr.	Gjyqtari	Nr. Çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme	Nr. Çështje të regjistruara të reja (nga data 01 Janar)	Nr. Çështjeve të gjykuara	Nr. Çështjeve në shqyrtim
1.	Arbër Çela	192	750	836	106
2.	Tonin Sterkaj	33	654	564	123
3.	Sokol Shehu	137	693	761	69
4.	Arta Llazari	555	679	642	592
5.	Izabela Radovani	97	210	307	0
6.	Hasan Selimi	56	3	59	0
7.	Besmir Stroka	152+1 Pukë=153	729	805	77
8.	Orgent Nazaj	278	877	958	197
9.	Amarilda Sulaj	71+35 Pukë= 106	74	180	0
10.	Albert Keraj	73+	383	293	163
11.	Kostandina Kuro	71	93	164	0
12.	Gentian Marku	32	28	60	0
13.	Egla Mirashi	0	171	63	108
14.	Elona Mërtiri	0	214	89	125
15.	Anisa (Tepelena) Brinja	0	203	81	122
TOTALI		1715+68 Pukë=1783	5761	5862	1682

Paraqitja grafike




1.4. Gjykimi sipas kategorive të gjykimit civile dhe penale

Seksioni penal : Ngarkesa e seksionit penal vijon te jetë e madhe duke marrë parasysh dhe ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale të cilat kanë rritur rolin e gjykatës, si dhe faktit që në juridiksionin e kësaj gjykate është edhe IEVP Reç Malësi e Madhe dhe kërkesat e shtetasve që vuajnë dënimin pranë këtij institucioni janë të shumta duke rritur kështu ngarkesën e seksionit penal të kësaj gjykate , i cili siç u përshkrua në fillim të kësaj analize për vitin 2022 është përbërë nga 4 (katër) gjyqtarë.

Një arsye tjetër është edhe implemetimi i Hartës së Re Gjyqësore duke rritur kështu juridiksionin territorial

Asesi seksioni penal i kësaj gjykate ka gjykuar si më poshtë :

- Mbartur nga viti 2022- 607 çështje
- Ardhur të reja për gjykim – 3754 çështje
- Gjykuar gjatë vitit 2023 – 3929 çështje
- Në pritje në vitin 2024 -432 çështje



Ky informacion përmban edhe çështjet e ardhura nga gjykata pukë që në total janë në kategorinë penale të shpallura 59 çështje për periudhën 01.01.2023 -30.04.2023 (katërmujori i parë i vitit 2023)

Seksioni civil: Ngarkesa e seksionit civil është po ashtu në rritje gjatë vitit 2023

Në Dhomën Civile për shkak të ndryshimeve të pësura në trupën gjyqësore të kësaj gjykate gjatë vitit 2022 shkarkimit të gjyqtarëve gjyqtarës Ermira Dedja dhe Andri Ymeri , seksioni ka funksionuar mesatarisht me 4.5 gjyqtarë që kanë qënë të ndyshueshëm siç është pasqyruar në hyrje të kësaj analize.

Për pasojë numri i çështjeve civile në mbartje për vitin 2023 ka qënë i madh .

Seksioni civil ka gjykuar edhe çështjet e hetimit paraprak për shkak të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale duke mos ezauruar trupat gjykues të kësaj gjykate.

Sa i përket çështjeve civile seksioni civil ka gjykuar si më poshtë :


- Mbartur nga viti 2022- 1176 çështje
- Ardhur të reja për gjykim – 2007 çështje
- Gjykuar gjatë vitit 2022 – 1933 çështje
- Mbartur në vitin 2023 -1250 çështje

Ky informacion përmban edhe çështjet e ardhura nga gjykata pukë që në total janë në kategorinë civile të shpallura 46 çështje për periudhën 01.01.2023 -30.04.2023 (katërmujori i parë i vitit 2023)




Më poshtë paraqesim në format table dhe grafikun e çështjeve të kategorisë penale dhe civile për vitet 2019 -2023

Viti	Ceshtje penale	Ceshtje civile	Totali	Nr. gjyqtareve
2019	4102	2576	6678	12
2020	3858	1813	5671	12
2021	3666	2328	5994	11
2022	3175	2248	5423	7.5
2023	3929	1933	5862	8.4
Totali	18730	10898	29628	



1.5 Në lidhje me mënyrën e përfundimit të çështjeve : Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjatë vitit 2023 ka përfunduar me vendime përfundimtare dhe jopërfundimtare çështjet sipas tabelës më poshtë:

Kategoria e gjyimit	Gjykuar	Me vendim përfundimtar	Me vendim tjetër
Penale	3929	3395	534
Civile	1933	1053	880
Totali	5862	4448	1414




1.6 Lidhur me llojin e natyrës së çështjeve, nga të dhënat statistikore rezulton se:

Në kategorinë e çështjeve civile gjatë vitit 2023 janë gjykuar 1933 ndër të cilat :

- Civile themeli me palë kundërshtare - 989 çështje
- Civile themeli pa palë kundërshtare - 1018 çështje


Në çështjet civile me palë kundërshtare janë gjykuar : civile të përgjithshme **399**, familjare me palë kundërshtare **556** ndër të cilat 328 çështje kanë qënë me objekt “zgjdhje martesë”, 195 çështje me objekt “Ligjin Për masat ndaj dhunës në mardhëniet familjare” dhe të tjerat çështje të tjera familjare. Gjithashtu gjykata ka përfunduar **32** çështje “Mardhënie pune”

Në çështjet civile pa palë kundërshtare janë gjykuar civile të përgjithshme pa palë kundërshtare 1018 çështje, ndër të cilat 558 janë çështje me objekt “Urdhër ekzekutimi” , 57 çështje janë familjare pa palë kundërshtare.



Në kategorinë e çështjeve penale gjatë vitit 2023 janë gjykuar :

- 729 çështje penale themeli të parashikuara nga Kodi Penal si “Krime”;
- 235 çështje penale themeli të parashikuara nga Kodi penal si “Kundravajtje”;
- 2965 çështje penale administrative ku përfshihen çështje në fazën e hetimit paraprak; në fazën e ekzekutimit dhe ato të gjykimit paraprak



Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit ët Përgjithshëm Shkodër në Dhomën Penale funksionon Seksioni për të Mitur, i cili përbëhet nga gjyqtarë të specializuar në këtë fushë, që gjykojnë njëkohësisht edhe çështjet për të rritur, konkretisht për vitin 2023 ky seksion është përbërë nga gjyqtarët Sokol Shehu, Arbër Çela, Tonin Sterkaj, Besmir Stroka dhe Orgent Nazaj

Gjyqtarët e Seksionit për të Mitur gjykojnë njëkohësisht dhe çështje për të rritur.

Në datën 1 janar 2018 kanë hyrë në fuqi dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe përmbajnë rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Gjatë vitit 2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit ët Përgjithshëm Shkodër janë regjistruar çështje penale ku të pandehur kanë qenë persona të mitur dhe kanë përfunduar gjatë këtij viti 88. çështje.

Nga të cilat janë gjykuar nga 52 penale themeli me të mitur dhe 36 gjykime paraprake.

Këto janë gjykime ku të miturit kanë qenë në cilësinë e të miturit në konflikt me ligjin ose të viktimës në procesin penal.


Në caktimin e masave të dënimit është aplikuar Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në rastet e tjera janë aplikuar dënimet alternative sipas Kodit Penal.

1.7 Lloji dhe masa e dënimit të aplikuar gjatë vitit 2023

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit të aplikuar nga gjykata në çështjet penale të gjykuara gjatë vitit 2022, referuar të dhënave statistikore konstatohet se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit ët Përgjithshëm Shkodër ka disponuar me vendime dënimi për 955 + 19 të mitur si më poshtë :

- Vendim me masë dënimi gjobë për 80 të gjykuar

- Vendim me masë dënimi burg në masën deri 2 vjet për 124 të dënuar ;
- Vendim me masë denimi burg në masën 2- 5 vjet për 66 të dënuar;
- Vendim me masë denimi burg në masën 5-10 vjet për 20 të dënuar ;
- Vendim me masë denimi burg në masën 10-25 vjet për 8 të dënuar
- Vendim me masë denimi burg në masën 25-35 vjet për 0 të dënuar
- Aplikim i nenit 59 të Kodit Penal për 511 të dënuar ,
- Aplikim i nenit 59/a të Kodit Penal për 16 të dënuar ,
- Aplikim i nenit 63 të Kodit Penal për 144 të dënuar ,



Lidhur me disponimet e gjykatës për “Masat e sigurimit personal” të dhënat janë nxjerrë referuar rregjistrin të masave të sigurimit dhe çështjeve në fazën e hetimit paraprak dhe pasqyrojnë të dhëna vetëm mbi masat e caktuara nga gjyqtarët kur çështja nuk përbën sekret hetimor .

Sa më sipër në këtë kategori gjykimi siç u pasqyrua më sipër janë gjykuar gjithsej 746 çështje për të cilat gjykata në lidhje me masat e sigurimi të paraqitura fillimisht në gjykatë ka disponuar si më poshtë :

- Në 138 raste “arrest në burg”
- Në 53 raste “Arrest në shtëpi”
- Në 101 raste “detyrim për tu paraqitur”
- Në 5 raste “mjekim i detyruar “


Masat e tjera janë zëvendësime apo vendime të tjera në vijim të hetimit , si dhe kërkesa me objekt “lejim përgjimi” , vleftësim përgjimi” “caktim mase sigurimi në mungesë” et, j të cilat përbëjnë sekret hetimor në momentin e marrjes së një vendimi dhe nuk pasqyrohen as në sisteme dhe as në rregjistra duke pasjellë pamundësi për grumbullimin e saktë të këtyre të dhënave

1.8 Mesatarja e çështjeve për gjykim për çdo gjyqtar :

Referuar të dhënave statistikore sipas vendimit 47 të Këshillit të Lartë Gjyqësor rezulton se mesatarja e çështjeve për gjykim dhe shpërndarje të gjyqtareve për vitin 2022 ka qënë sipas tabelës më poshtë:

STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE				
Numri i gjyqtarëve në gjykatë	Totali i çështjeve të reja të paraqitura për gjyqtar	Totali i çështjeve të gjykuara për gjyqtar	Totali i çështjeve për gjyqtar	Totali i çështjeve të mbartura për gjyqtar
1	2	3	4	5
8.4	686	698	898	200

Nga Janari 2023 e deri në Dhjetor 2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër kanë ushtruar efektivisht detyrën, duke marrë pjesë edhe në short, gjithsej 8.4 gjyqtar.



1.9 Kërkesat për heqje dorë:

Gjatë vitit 2023 janë shqyrtuar nga Zëvendëskryetari i Gjykatës 88 “Kërkesa për heqje dorë”, nga të cilat 76 kërkesa janë miratuar.


1.10 Përjashtimet e shqyrtuara gjatë vitit 2023

Kërkesat për përjashtimin e gjyqtarit janë paraqitur gjithsej 25, nga të cilat 13 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit në proces penal dhe 12 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit në proces civil

Gjykata ka disponuar në lidhje me këta kërkesa si më poshtë:

- Në 13 kërkesa penale të paraqitura me objekt “Përjashtim gjyqtari” , janë pranuar 2;
- Në 12 kërkesa civile me objekt “Përjashtimin e gjyqtarit” janë pranuar 0;

Paraqitje Grafike



II. SHPEJTËSIA NË GJYKIM

Përsa i përket shpejtësisë në gjykim, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër paraqet tregues të kënaqshëm në funksion të dhënies së drejtësisë, brenda një afati të arsyeshëm kohor sipas detyrimeve procedural dhe parashikimeve kushtetuese të nenit 42/2 dhe nenit 6§1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Një pengesë në shpejtësinë e gjykimit edhe në vitin 2023 e bën sistemi i shërbimit postar të njoftimeve, shtrirja e gjerë territoriale në të cilën ushtron veprimtarinë Gjykata dhe mungesa e një sistemi të saktë adresash.

Faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në shpejtësinë në gjykim janë kërkesat e palëve për tu mbrojtur me avokat pa e siguruar një mbrojtje të tillë para se të fillojë procesi gjyqësor dhe për të paraqitur prova, paraqitja e kërkesave për shtyrje të seancës, nisur nga pjesëmarrja në gjykim tjetër etj.

Ndër faktorët e tjerë të brendshëm që ndikojnë në shpejtësinë e gjykimit është ngarkesa shumë e lartë në punë për secilin gjyqtar, referuar numrit mesatar të çështjeve për gjyqtar dhe organikës së gjykatës, numrit të delegimeve të gjyqtarëve në gjykata të tjera.

Referuar të dhënave statistikore :

Sipas Komisionit Evropian për Eficencën në Drejtësi (CEPEJ) për të analizuar e të dhënat statistikore në tërësi përdoren 2 indikatorë që janë Clearance Rate (CR indikator) i cili tregon raportin midis çështjeve të regjistruara me çështjet e përfunduara në përqindje dhe Disposition Time (DT) i cili tregon raportin e shpejtësisë së përfundimit të çështjeve gjyqësore të ardhura në gjykatë në ditë.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër rezulton se Clearance Rate për çështjet Penale (Treguesi Normale përfundimit/Likuidimit e çështjeve) gjatë vitit 2023 është **90.84 %** për afërsisht **91 %** dhe Clearance Rate për çështjet Civile është **84.60 %** për afërsisht **85 %**.

Koha e nevojshme për përfundimin e një çështje penale për vitin 2021 është **66** ditë dhe për çështjet civile është **185** ditë.

Clearance rate penal (Treguesi Norma e Përfundimit/Likuidimit të Çështjeve)

$$CR_{penale}2023 = \frac{\text{numri i çështjeve të përfunduara}}{\text{numri i çështjeve të reja}} * 100 = \frac{3929}{3754} * 100 = 104.6 \%$$

Clearance rate Civil (Treguesi Norma e Përfundimit/Likuidimit të Çështjeve)

$$CR_{civile}2023 = \frac{\text{numri i çështjeve të përfunduara}}{\text{numri i çështjeve të reja}} * 100 = \frac{1933}{2007} * 100 = 96.3 \%$$

Case disposition time penale (Koha e nevojshme për Përfundimin/Likuidimin e Çështjeve)

$$DT_{penale}2023 = \frac{\text{numri i çështjeve në pritje për gjykim më 31.12.2022}}{\text{numri i çështjeve të zgjidhura}} * 365 = \frac{432}{3929} * 365 = 40.13$$

Case disposition time civile (Koha e nevojshme për Përfundimin/Likuidimin e Çështjeve)


$$DT_{civile}2023 = \frac{\text{numri i çështjeve në pritje për gjykim më 31.12.2022}}{\text{numri i çështjeve të zgjidhura}} * 365 = \frac{1250}{2007} * 365 = 227.3$$

2.1 Në lidhje me përfundimin e çështjeve gjyqësore:

Seancat penale : Gjatë vitit 2023 kanë përfunduar për periudhën deri në 6 muaj 98% e çështjeve Penale, kanë përfunduar brenda periudhës 6 muaj - 1 vit, - 2% e çështjeve,

Paraqitje Grafike


Grafiku bazuar në numrin e seancave: Penale



Seancat civile: Ndërkaq, kanë përfunduar për periudhën deri në 6 muaj 69% e çështjeve civile, kanë përfunduar brenda periudhës 6 muaj - 1 vit - 17% e çështjeve, 1 – 2 vjet -11%, dhe mbi 2 vjet vetëm 3% e tyre (Shiko grafikun Nr. poshtë).

Paraqitje Grafike

Grafiku bazuar në kohëzgjatjen e çështjeve: Civile



2.2 Të dhëna referuar kohëzgjatjes e çështjeve të gjykuara civile dhe penale


Gjatë vitit 2023 ka përfunduar gjykimi i çështjeve si më poshtë :

- Brenda afatit 6 mujor për 3854 çështje penale dhe për 1342 çështje civile
- Brenda afatit 6-12 muaj mujor për 60 çështje penale dhe për 321 çështje civile

- Brenda afatit mbi 1 -2 vjet vit për 13 çështje penale dhe për 216 çështje civile
- Mbi 2 vite 2 çështje penale dhe 54 çështje civile

Paraqitje Grafike

Grafiku bazuar në kohëzgjatjen e gjykrimeve: Civile dhe Penale



Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në shpejtësinë e gjykimit padiskutim më i rëndësishmi mbetet sistemi i adresave, i cili i lidhur me ndryshimet procedurale ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit.

Megjithatë, në shpejtësinë e gjykimit ndikojnë edhe faktorë të tjerë, menaxhimi i çështjes për gjykim nga ana e vetë gjyqtarit, lloji i gjykimit (gjykimi i shkurtuar ose i drejtpërdrejtë në çështjet penale dhe ai i kërkesave civile), kompleksiteti i çështjes, realizimi i njoftimeve të rregullta të palëve e dëshmitarëve, përgjigja e institucioneve publike e private, etj., faktorë ndër të cilët vend të veçantë zë edhe sjellja e palëve ndërgjyqëse gjatë gjykimit, çka rezulton ende të jetë shkak kryesor për shtyrjen e seancave gjyqësore.

III. MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA DHE PUBLIKUN

Si një ndër institucionet kryesore me të cilat gjendet në marrëdhënie të vazhdueshme pune, marrëdhëniet me prokurorinë pranë kësaj gjykate kanë qenë në fokus të vazhdueshëm në funksion të përmirësimit të proceseve të punës dhe zgjidhjes së problematikave të hasura.

Veçanërisht rëndësi i është kushtuar dorëzimit të vendimeve brenda afatit ligjor, komunikimit të tyre palëve dhe dërgimit të dosjeve në gjykatën e apelit, problematikë kjo e mëparshme, e ngritur si shqetësim nga ana e Prokurorisë.

Po kështu, është arritur zgjidhja e problematikave të ndërsjella nëpërmjet bashkëpunimit dhe përcjelljes së shqetësimeve ndër dy institucionet, çka ka çuar në përmirësim të vazhdueshëm të procesit të punës. Rëndësi e veçantë i është kushtuar vendosjes së praktikave në lidhje me zbatimin sa më korrekt dhe efektiv të ndryshimeve procedurale.

Sjellja e prokurorëve reflektohet përgjithësisht korrekte, duke u evidentuar raste jo të shpeshta të mospjesëmarrjes në gjykim pa njoftuar paraprakisht gjykatën, apo paraqitjes me vonesë në fillimin e seancës gjyqësore. Megjithatë, vlen të theksohet se përgjithësisht problematikat e ngritura respektivisht nga të dy institucionet kanë gjetur përgjigje.

Sa i takon marrëdhënieve me Dhomën e Avokatisë Shkodër, përgjithësisht nga ana e avokatëve është reflektuar sjellje korrekte përsa i përket solemnitetit dhe orarit të gjykimeve. Në raste të veçanta gjyqtarët kanë njoftuar Dhomën e Avokatisë për marrjen e masave ndaj avokatëve konkretë. Problem mbetet shlyerja e pagimit të gjobave nga ana e avokatëve, në rastet e caktuara nga gjykata.

Nga ana tjetër, në kuptim të Nenit 49/3 të Kodit të Procedurës Penale, Dhoma e Avokatisë Shkodër ka paraqitur rregullisht *“Listën e avokatëve të gatshëm për t’u caktuar kryesisht”*, e cila përgjithësisht respektohet nga gjyqtarët në varësi të ngutshmërisë së çështjes dhe gatishmërisë së avokatëve të listuar.

Mbetet ende për t’u zgjidhur kërkesa e vazhdueshme e Dhomës së Avokatisë Shkodër për sigurimin e një ambienti të veçantë për avokatët, i cili pavarësisht vullnetit tonë pozitiv nuk është bërë ende i mundur të sigurohet për shkak të pamjaftueshmërisë së ambienteve të godinës.

Lidhur me marrëdhëniet me publikun, Gjykata e Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në mënyrë të veçantë i ka kushtuar rëndësi transparencës e cila ndihmon në përmbushjen e besueshmërisë për drejtësi, nëpërmjet bërjes publike dhe afishimit elektronikisht në hapësirën e pritjes së palëve ndërgjyqëse ku shpallen listat e gjykimeve, lista e çështjeve të hedhura në short, urdhrave të ndryshme të Këshillit të Gjykatës.

Mjaft efektive për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka rezultuar komunikimi me publikun nëpërmjet faqes elektronike zyrtare duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji si të detyrueshëm për publikim.

Dokumentacioni i bërë publik, është i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

Gjithashtu, i është kushtuar rëndësi aksesit të të interesuarve në dokumentacionin dhe aktet e gjendura në gjykate.

Por pavarësisht moszhvillimit të këtyre aktiviteteve, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka dhënë një ndihmesë dhe mundësi për të diplomuarit në drejtësi për një praktikë profesionale të tyre pranë kësaj gjykate.

Në përfundim, duke vlerësuar se të dhënat e analizuar dhe problematikat e ngritura në këtë analizë pune për vitin 2023 do t’i shërbejnë si trupës gjyqësore, ashtu edhe institucioneve të tjera përkatëse që lidhen me sistemin gjyqësor, dëshiroj të shpreh në emrin tim dhe të trupës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër angazhimin tonë maksimal për rritjen në vijimësi të performancës së kësaj gjykate.

Dëshiroj të falenderoj për mbështetjen dhe punën e pakursyer që kanë ndërmarrë e përfunduar gjatë vitit 2023. trupën gjyqësore të kësaj gjykate si fillim dhe në veçanti administratën mbështetëse për rolin e madh dhe të rëndësishëm dhe punën e kryer në kushte shumë të vështira me qëllim sigurimin e vijimsisë së veprimtarisë së gjykatës edhe gjatë implementimit të hartës së re gjyqësore ashtu edhe në vijim gjatë gjithë këtij viti.

Duke ju falënderuar, ju uroj mbarësi të gjithëve!

ZV/ KRYETAR I GJYKATËS

SOKOL SHEHU